

FORMULARI I ANKESAVE QË I DËRGOHET ADMINISTRATORIT TË SHËRBIMIT



Adria Ferries Spa

Via Thaon de Revel, 4

60124

Ancona

Itali

Të dhënat e personit që paraqet ankesën

Emri:	Mbiemri:	
Emërtimi (nëse nuk është person fizik):		
Adresa:		
Kodi postar:	Qyteti:	Shteti:
E-mail:		
Telefoni (fakultativ):		

Të dhënat e përdoruesit (nëse janë të ndryshme nga personi që paraqet ankesën) dhe të pasagjerëve të tjerë eventual

Emri:	Mbiemri:
Emri:	Mbiemri:
Emri:	Mbiemri:
Emri:	Mbiemri:

Agjenti i udhëtimit/operatori turistik/shitësi i biletave (nëse ka):		
Kodi i rezervimit/numri i biletës:		
Porti/terminali i nisjes:	Porti/terminali i mbërritjes:	
Orari i nisjes së planifikuar:	- ora:	data (dd/mm/vv):
Orari aktual i nisjes (nëse nuk përkon me orarin e planifikuar)	- ora:	data (dd/mm/vv):
Orari i mbërritjes së planifikuar	- ora:	data (dd/mm/vv):
Orari aktual i mbërritjes (nëse nuk përkon me orarin e planifikuar)	- ora:	data (dd/mm/vv):

Motivet e ankesës. Ju lutemi vendosni një shenjë spuntimi pranë zërave përkatëse (*)

- Lëshimi i biletës / kushtet kontraktuese ose tarifat diskriminuese
- Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të zvogëluar
- Informacione në rast anulimesh ose nisjesh të vonuara
- Informacione mbi udhëtimin
- Informacione mbi të drejtat e pasagjerëve
- Transport alternativ ose rimbursim në rast nisjesh të anuluar ose të vonuara
- Asistencë në rast nisjesh të anuluar ose të vonuara
- Vonesë në mbërritje dhe kërkesë për kompensim ekonomik

Zgjidhni mënyrën se si dëshironi ta merrni kompensimin, nëse ju takon:

Bono ose shërbime të tjera

Kartë krediti

Urdhërshirim bankar – IBAN:

Vështirësi në paraqitjen e ankesës

Tjetër:

Përshkrimi. Ju lutemi, përshkruani se çfarë ka ndodhur në lidhje me të gjithë zërat për të cilët është treguar shenja e spuntimit

(*) Për informacione mbi të cilat janë të drejtat e pasagjerëve që udhëtojnë me rrugë detare dhe rrugë ujore të brendshme që njihen nga rregullorja (BE) n. 1177/2010 është e mundur të konsultohet faqja *web* e internetit e Autoritetit të rregullimit të transporteve në adresën:

<https://www.autorita-trasporti.it/trasporto-via-mare-e-per-vie-navigabili-interne/>

Bashkëlidhur

Delegimi dhe dokumenti i identitetit të përdoruesit (në rast se ankesa paraqitet nga një subjekt i ndryshëm nga përdoruesi)

Aneksa të tjerë

FIRMA E PERSONIT QË PARAQET ANKESËN: _____

Vendi: _____

Data: _____

ADRIA FERRIES S.P.A.

INFORMATIVA E PRIVATËSISË

Ky dokument përshkruan parimet rregulluese për trajtimin e të dhënave nga ana e ADRIA FERRIES S.P.A. (me seli ligjore në Via Thaon de Revel n. 4, 60124 Ancona (AN), në vijim edhe "Adria Ferries" ose "Shoqëria"), me detyrë si Titullare e Trajtimit.

Dëshirojmë t'ju informojmë për modalitetet e trajtimit të të dhënave personale që keni dhënë në momentin e regjistrimit për shërbimet e ndryshme që arrihen në faqen e internetit www.adriaferries.com.

Saktësojmë që tani se, për sa i përket shërbimeve të ofruara, të dhënat tuaja do të trajtohen në mënyrë të ligjshme, korrekte dhe transparente, duke u siguruar që ato të jenë të sakta, adekuate, të kenë lidhje me shërbimin që jepet dhe të kufizuara në atë që është e nevojshme, karshi qëllimeve që synohen të arrihen herë pas here, në varësi të shërbimit që përdoret.

Të dhënat e regjistruara nga Adria Ferries trajtohen në përputhje me atë çka është parashikuar nga Rregullorja BE n. 679/2016, "për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me trajtimin e të dhënave personale, gjithashtu edhe për qarkullimin e lirë të këtyre të dhënave e që shfuqizon direktivën 95/46/BE" (në vijim "Rregullorja" ose "GDPR"). Informacionet në lidhje me Cookie Policy të adoptuara nga Shoqëria për këtë faqe interneti, përmbahen në seksionin e vetë faqes së internetit.

Titullari i trajtimit	Adria Ferries S.p.A. me seli ligjore në Via Thaon de Revel n. 4, 60124 Ancona (NIPT: 02197160423)
Qëllimet	Përfundimi, administrimi dhe ekzekutimi i operacioneve që lidhen me kontratën e transportit detar
Baza juridike	Përmbushja e detyrimeve kontraktuese, masave para-kontraktuese dhe ligjore me qëllim që të administrohet kontrata e transportit detar
Transferimi i të dhënave	Mundësohet, duke qenë të mundura garancitë adekuate për mbrojtjen e të drejtave të të Interesuarit
Të drejtat e të Interesuarit	<ul style="list-style-type: none">• Ka akses në të dhënat personale;• Ka të drejtën e korigjimit ose eliminimit të tyre ose kufizimin e trajtimit të të dhënave;• Ka të drejtën e portabilitetit të të dhënave;• Të kundërshtojë trajtimin e të dhënave;• Të drejtën e ankesës tek autoriteti kompetent i kontrollit.

TITULLARI I TRAJTIMIT

Titullari për trajtimin e të dhënave është:

Adria Ferries S.p.A., me seli ligjore në via Thaon de Revel n. 4, 60124 Ancona, Italia (NIPT: 02197160423).

Mund të drejtoheni te Adria Ferries në çdo moment për të ushtruar të drejtat tuaja, ashtu siç janë specifikuar në këtë dokument, duke dërguar një komunikim te: privacy@adriaferries.it

PËRGJEGJËSIT E JASHTËM PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE

Për të përmbushur qëllimet e trajtimit, që specifikohen më poshtë, Titullari mbështetet tek Agjencitë Detare (të emëruara si Përgjegjëse të Trajtimit) dhe Agjencitë (të emëruara si Nën-Përgjegjëse të Trajtimit).

Përveç kësaj, të gjithë furnizuesit e shërbimeve të jashtme janë emërtuar Përgjegjës të Trajtimit.

Titullari i Trajtimit ka caktuar një **Përgjegjës për Mbrojtjen e të dhënave**, që zotëron njohuri të specializuara në lidhje me normativën dhe praktikën në lëmin e mbrojtjes së të dhënave, i cili pra është i aftë të kryejë detyrat në përputhje me nenin 39 të rregullores Reg. BE n. 679/2016 dhe që mund të kontaktohet në adresën e mëposhtme e-mail: dpo@adriaferries.it

OBJEKTI I TRAJTIMIT

Operacionet e trajtimit mund të kenë të bëjnë me:

- të dhënat anagrafike (emrin, mbiemrin, adresën, datën dhe vendin e lindjes);
- të dhënat e kontaktit (e-mail dhe numër telefoni);
- të dhënat në lidhje me përkatësinë e kategorive profesionale ose me regjistrimin në programet e besnikërisë ose të anëtarësimit të nënshkruara me shoqëritë e palëve të treta.

Përveç kësaj, ka mundësi që të jetë bërë trajtimi i disa të dhënave të ndjeshme në përputhje me nenin 9 të Rregullores BE n. 679/2016:

- të dhënat në lidhje me nevojat e veçanta për shkak të gjendjes shëndetësore.

Regjistrimi i të dhënave të ndjeshme është fakultativ. Regjistrimi dhe trajtimi i tyre jo vetëm do t'i japë mundësi Shoqërisë që të plotësojë më mirë nevojat e pasagjerëve, por edhe të arrijë qëllimin e parashikuar nga Ministria e Infrastrukturave dhe Transporteve n. 104/2014, d.m.th. "*mbledhjen e informacioneve dhe të dhënave mbi pasagjerët [...] për të lehtësuar operacionet e kërkimit dhe të ndihmës dhe për të optimizuar burimet e nevojshme për të përballuar një ngjarje SAR*".

QËLLIMET E TRAJTIMIT PËR TË CILIN JANË DESTINUAR TË DHËNAT

(NENI 24 GERMA A, B, C KODI I PRIVATËSISË DHE NENI 6 GERMA B, E GDPR)

Të dhënat tuaja do të trajtohen për qëllimet e specifikuar herë pas here në një informativë përkatëse të dhënë përpara hyrjes në secilin shërbim dhe në lidhje me të cilat do t'ju kërkohet të jepni shprehimisht miratimin për trajtimin e tyre (që do të përbëjë bazën juridike të vetë trajtimit). Më poshtë janë të renditura qëllimet që synohen të arrihen me anën e regjistrimit të shërbimeve të qasshme në faqen e internetit.

Në veçanti, të dhënat do të trajtohen për qëllime që kanë lidhje me detyrimet reciproke që rrjedhin nga kontrata e transportit detar:

1. administrimi i kërkesave të preventivit;
2. përfundimi, administrimi dhe ekzekutimi i operacioneve që lidhen me kontratën e transportit detar;
3. dërgimi i informacioneve në lidhje me udhëtimin e blerë (p.sh. vonesat e mundshme, etj.);
4. furnizimi në bordin e anijes të produkteve dhe të shërbimeve të blera;
5. nxjerrja e informacioneve me natyrë statistikore, në formë anonime;
6. transmetimi i të dhënave për agjencitë detare, autoritetet portuale, autoritetet gjyqësore dhe forcat e rendit;
7. dërgimi i ankesave në lidhje me transportin detar.

Dhënia e miratimit, për trajtimin e të dhënave tuja personale, do të jetë fakultative ose e nevojshme në varësi të qëllimeve që synohen të arrihen për secilin shërbim; megjithatë saktësojmë që tani se, atëherë kur të jetë e nevojshme që të jepet, në rastin e refuzimit tuaj, Adria Ferries nuk do të jetë në gjendje të ofrojë shërbimin ose do ta furnizojë atë pjesërisht.

MODALITETET PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE

(NENI 4 KODI I PRIVATËSISË DHE NENI 5 GDPR)

Të dhënat personale do të trajtohen edhe me ndihmën e instrumenteve informatikë, në përputhje me modalitetet e përcaktuara në GDPR, e cila parashikon, përveç të tjerave, që të dhënat:

- të trajtohen sipas principeve të ligjshmërisë, transparencës dhe korrektësisë;
- të mbliidhen dhe të regjistrohen për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime ("kufizimi i qëllimeve");
- të jenë adekuate, të kenë lidhje me shërbimin dhe të jenë jo të tepërta për sa i përket formaliteteve të trajtimit ("minimizimi i të dhënave");
- të jenë të sakta dhe të azhuruara ("saktësia");
- të ruhen për një periudhë kohe që nuk e tejkalon arritjen e qëllimeve për të cilat trajtohen ("kufizimi i ruajtjes");
- të trajtohen duke përdorur instrumente të përshtatshëm që garantojnë sigurinë dhe privatësinë, duke përfshirë mbrojtjen nga trajtimet e paautorizuara ose të paligjshme dhe nga humbja, shkatërrimi ose dëmtimi aksidental ("integriteti dhe privatësia").

Të dhënat personale ruhen për një periudhë prej 10 vjetësh nga përfundimi i udhëtimit me qëllim që të ruhen librat kontabël dhe për nevojat e mundshme që lindin si rezultat i mosmarrëveshjeve me pasagjerët.

Titullari do t'i trajtojë të dhënat personale për kohën e nevojshme që nevojitet për përmbushjen e qëllimeve të lartpërmendura dhe në çdo rast jo më shumë se 36 muaj nga përmbledhja e miratimit për trajtimin, miratim i cili mund të revokohet në çdo kohë pa rrezikuar ligjshmërinë e trajtimit që është kryer përpara revokimit.

TË DHËNAT	KOHA E RUAJTJES	QËLLIMET E RUAJTJES
<ul style="list-style-type: none"> • Të dhënat anagrafike dhe të kontaktit; • Të dhënat në lidhje me përkatësinë e kategorive profesionale ose me regjistrimin në programet e besnikërisë ose të anëtarësimit të nënshkruara me shoqëritë e palëve të treta; • Të dhënat e mundshme në lidhje me nevojat e veçanta për shkak të gjendjes shëndetësore 	<p>10 vjet nga përfundimi i udhëtimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja në librat kontabël <p>Lindja e mosmarrëveshjeve të mundshme nga</p> <ul style="list-style-type: none"> • pasagjerët

BAZA JURIDIKE

Baza juridike e trajtimeve të listuara më lart ("Qëllimet e trajtimit për të cilin të dhënat janë të destinuara" par. 2, pikat 1-5) identifikohen në përmbushjen e detyrimeve kontraktuese, të masave para-kontraktuese dhe ligjore me qëllim që të administrohet kontrata e transportit detar.

Për pikën 7 të paragrafit 2 "Qëllimet e trajtimit për të cilin të dhënat janë të destinuara" baza juridike e trajtimit mund të identifikohet në përmbushjen e detyrimeve ligjore të cilave i nënshtrohet Titullari dhe për interesin publik që ka ruajtja e sigurisë në porte.

TRANSFERIMI DHE/OSE KOMUNIKIMI I TË DHËNAVE

Të dhënat mund t'i komunikohen, përveçse shoqërive të tjera të grupit të cilat bën pjesë Adria Ferries, gjithashtu edhe subjekteve të vendosura në Vendet e treta, edhe jashtë territorit të Bashkimit Evropian, duke respektuar procedurat e përshtatshme dhe brenda qëllimeve të lartpërmendura. Përveç kësaj, mund të rezultojë se është e nevojshme për Adria Ferries - mbi bazën e ligjeve, procedurave ligjore, mosmarrëveshje dhe/ose kërkesave të bëra nga autoritetet publike ose qeveritare brenda ose jashtë Shtetit të rezidencës së palës së interesuar, për qëllimet e sigurisë kombëtare dhe/ose për çështje të tjera me rëndësi publike - komunikimi i të dhënave personale. Kur është e mundur ligjorisht, Adria Ferries do të informojë palën e interesuar përpara një komunikimi të tillë.

Adria Ferries gjithashtu mund t'i komunikojë të dhënat personale nëse vendos me mirëbesim se një komunikim i tillë është i arsyeshëm e i nevojshëm për të zbatuar dhe mbrojtur të drejtat e saj dhe për të aktivizuar masat e duhura në dispozicion.

TË DREJTAT E TË INTERESUARIT

(NENI 7 KODI I PRIVATËSISË DHE NENI 15 - 21 GDPR)

Ju informojmë gjithashtu se për çdo shërbim për të cilin regjistroni, kurdoherë mund të ushtroni të drejtat e mëposhtme:

- qasje në të dhënat personale, duke kërkuar që këto të dhëna të vihen në dispozicionin tuaj në një formë të kuptueshme, si dhe për qëllimet në të cilët bazohet trajtimi (ex neni 15);
- të drejtën e korrigjimit (ex neni 16) ose eliminimit (ex neni 17) të tyre ose kufizimin e trajtimit të të dhënave (ex neni 18);
- të drejtën për portabilitetin e të dhënave (ex neni 20);
- të drejtën për trajtimin e të dhënave (ex neni 21);
- të drejtën e ankesës tek autoriteti kompetent i kontrollit.

Të drejtat e lartpërmendura mund të kërkojnë, duke i drejtuar kërkesat në adresën e mëposhtme e-mail: privacy@adriaferries.it

Për këtë qëllim, sinjalizohet gjithashtu se Përgjegjësi për Mbrojtjen e të Dhënave (DPO) i emëruar nga Shoqëria mund të kontaktohet në adresën e mëposhtme e-mail: dpo@adriaferries.it

NATYRA E DORËZIMIT TË TË DHËNAVE DHE PASOJAT E MUNGESËS SË MUNDSHME TË KOMUNIKIMIT TË TË DHËNAVE

Dorëzimi i të dhënave është i nevojshëm për ekzekutimin e saktë të detyrimeve kontraktuese dhe para-kontraktuese në ngarkim të Shoqërisë dhe mos paraqitja e tyre sjell pamundësinë e lidhjes së kontratës së transportit detar, si dhe të përmbushjes me saktësi të detyrimeve ligjore dhe të atyre që rrjedhin nga interesi publik për ruajtjen e sigurisë në porte.

FIRMA PËR LEXIMIN DHE NJOHJEN E INFORMATIVËS SË PRIVATËSISË: _____